

VENDIM
Nr.111, datë 4.11.2011

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS PËR NDËRTIMIN,
INSTALIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E CENTRALIT ELEKTRIK, SI DHE PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, ME SERI NPM06K, NR. 41, LËSHUAR ME VENDIM TË
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.83, DATË 27.11.2006 PËR SHOQËRINË
ENERGO – SAS SHPK**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pika 2.3 e “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe neneve 15 pika 2 germa “b”, dhe pika 4 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18 pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009, të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.11.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Energo - SAS” sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr.41, seria NPM06K, për ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e centralit elektrik, si dhe prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.83, datë 27.11.2006 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Energo-SAS" sh.p.k. plotëson kërkesat e “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës.

- Neni 15, pika 4, germa “b”: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës me nr.41, seria NPM06K, të shoqërisë “Energo-SAS” sh.p.k. “Për ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e centralit elektrik, si dhe prodhimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.83, datë 27.11.2006.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani